FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.99 2004 20 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9324 datë 6.12.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Eksport-Import të Koresë për projektin e elektrifikimit të zonave rurale"…	6715
Vendim i KM nr.820, datë 3.12.2004	Për shpalljen e muajit dhjetor "Muaji i festimeve të Vitit të Ri"..	6721
Vendim i KM nr.828, datë 10.12.2004	Për një shtesë në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", të ndryshuar.....	6721
Vendim i KM nr.834, datë 10.12.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar	6722
Udhëzim i MRRTT nr.7, datë 16.12.2004	Mbi përcaktimin e normave teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave publike.....	6724
Udhëzim i MRRTT nr.8, datë 17.12. 2004	Mbi përcaktimin e kushteve të përdorimit të varrezave publike, mënyrës së hapjes së varreve dhe të dhënat teknike të arkivoleve që përdoren.....	6726
Urdhër i MBU nr.532 datë 6.12.2004	Për disa ndryshime në urdhrin e Ministrit nr.98, datë 26.2.2004 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit"……	6729

Shpallje kërkese për shpronësim me objekt për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kthesa e Shëngjinit-Ura e Re Lezhë..... 6731

Shpallje kërkese për shpronësim me objekt për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve përfshihen në projektin e ristrukturimit të Aeroportit të Rinasit”..... 6734

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Piro Trifoni..... 6734

LIGJ
Nr.9324, datë 6.12.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EKSPORT-IMPORT TË KORESË PËR PROJEKTIN E ELEKTRIFIKIMIT TË ZONAVE RURALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Eksport-Import të Koresë për projektin e elektrifikimit të zonave rurale".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4426, datë 16.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA E HUASË

Marrëveshja e huasë datë…… ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë kryer nga dhe përmes Ministrisë së Financave (Huamarrësi) dhe Bankës Eksport-Import të Koresë (Banka), e cila është besuar nga Qeveria e Republikës së Koresë në operimin dhe menaxhimin e Fondit për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (EDCF).

Në dëshmi të kësaj:

ku, Qeveria e Republikës së Koresë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë hyri në Marrëveshje në datën 26 maj 2004 lidhur me shtimin e huave EDCF për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë ose agjencinë e saj, e përcaktuar për zbatimin e projekteve të rënë dakord ndërmjet dy qeverive,

ku, bazuar në Marrëveshjen e mësipërme, Qeveria e Republikës së Koresë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë hyri në datën 26 maj 2004 në rregullimin lidhur me huanë EDCF për të financuar zbatimin e projektit të elektrifikimit të zonave rurale përshkruar në përshkrimin e projektit bashkëngjitur skedulit I (pas kësaj do të quhet "Projekt"),

ku, në kuadrin e Marrëveshjes dhe rregullimit, Banka ka rënë dakord të shtojë një hua për Huamarrësin mbi termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje,

tani dhe për këtë arsye, Huamarrësi dhe Banka ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Terma të përgjthshme dhe kushtet; përkufizime

Seksioni 1.01 Termat e përgjthshme dhe kushtet

Termat e përgjithshme dhe kushtet për Marrëveshjen e huasë "EDCF" të Bankës, datuar në tetor 2001, me modifikimet e mëposhtme të saj (pas kësaj do të quhen "Terma të përgjithshme dhe kushtet") do të formojnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje huaje, duke siguruar që neni 5 i termave të përgjithshme dhe kushtet nuk do të merren parasysh dhe të gjitha referencat për "Garantuesin" ose "Garanci" në termat e përgjthshme nuk do të merren gjithashtu parasysh.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Po të mos jetë kërkuar ndryshe konteksi, disa terma të përcaktuar në termat e përgjithshme dhe kushtet kanë kuptime respektive të parashtruara në to dhe termat shtesë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Agjencia e realizimit të projektit" do të jetë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.), e cila është autorizuar të zbatojë projektin.

"Furnizues" do të thotë furnizues(it), kontraktor(ët) ose konsulent(ët) nga të cilët mallrat ose shërbimet që do të financohen janë prokuruar nga shuma e huasë.

"Vend(e) origjinë i pranueshëm(e)" do të thotë Republika e Koresë dhe Republika e Shqipërisë.

"Huaja" do të thotë lehtësim huaje që do të bëhet e përdorshme në favor të Huamarrësit ose shuma e principalit të huasë së disbursuar dhe kohë mbas kohe e shtyrë, siç mund të jetë kërkuar në konteks.

"Datë e shlyerjes" do të thotë çdo 40 gjysmë viti të datës së njëpasnjëshme 20 mars dhe 20 shtator nga dhe duke përfshirë datën e cila do të jetë dita e 20-të e muajit (126) njëqind e njëzet e gjashtë pas datës së kësaj Marrëveshjeje huaje.

"Datë e pagesës së interesit" do të thotë secila nga datat 20 mars dhe 20 shtator të çdo viti.

Neni 2

Huaja

Seksion 2.01 Shuma dhe qëllimi i huasë

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit mbi bazën e termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje huaje, një shumë në *won* koreanë, e cila nuk do të kalojë shumën prej njëzet e pesë milionë dollarëve (25 000 000 $), për të financuar zbatimin e projektit.

b) Shuma e huasë do të emërohet në won koreanë dhe do të fiksohet nga Banka në përputhje me seksionin 3.01 të termave të përgjithshme dhe kushteve. Më pas Banka do të njoftojë Huamarrësin për shumën e huasë.

Seksioni 2.02 Përdorimi i shumës së huasë

a) Huamarrësi do të përdorë shumën e huasë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për zbatimin e projektit nga furnizues të vendeve të pranueshme. Shuma e huasë do të përcaktohet në përputhje me përcaktimin e shumës së huasë bashkëngjitur skedulit 2.

b) Disbursimi final sipas kësaj Marrëveshjeje huaje do të bëhet brenda 40 (dyzet) muajve pas datës efektive të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe nuk do të bëhen disbursime të mëvonshme nga Banka po të mos jetë rënë ndryshe dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

Neni 3

Shlyerja dhe interesi

Seksioni 3.01 Shlyerja e principalit

a) Huamarrësi do t'i shlyejë Bankës shumën principale të huasë të disbursuar në won koreanë në 40 (dyzet) këste gjysmëvjetore të barabarta në secilën datë të shlyerjes.

b) Data e shlyerjes dhe shuma e paguar në won koreanë për secilën datë të shlyerjes do të specifikohet në skedulin e amortizimit në formën dhe përmbajtjen të bashkëngjitur skedulit 3.

Skeduli i amortizimit do të bëhet nga Banka kur të fiksojë shumën e huasë dhe do të njoftojë Huamarrësin për skedulin e amortizimit kur ajo të njoftojë Huamarrësin për shumën e huasë në përputhje me paragrafin (b) të seksionit 2.01

Seksion 3.02 Pagesa e interesit

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës interesa mbi shumën principale të huasë së disbursuar dhe të llogaritur në përqindjen e 2.5 për qind (2.5%) në vit. Ky interes do të paguhet me këste në çdo datë të pagesës së interesit, duke siguruar që interesi i parë për çdo disbursim të bërë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh përpara çdo date të pagesës së interesit mund të paguhet në datën e ardhshme të datës së interesit.

Seksioni 3.03 Vendi i pagesës

Të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi për Bankën sipas Marrëveshjes së huasë do të paguhen në llogarinë (llogaria nr. 068-13-10395-6) e Bankës së Këmbimit të Koresë, dega Yoido-Gwangjang, në 12, Yoido-dong Youngdungpo-gu, Seoul 150-010 ose në çdo llogari tjetër në mënyrë të tillë siç do të përcaktohet nga Banka për Huamarrësin.

Neni 4
Prokurimet dhe disbursimet

Seksioni 4.01 Procedura e prokurimit

a) Të gjitha mallrat dhe shërbimet që do të financohen prej shumës së huasë, do të prokurohen përmes furnizuesve në përputhje me dispozitat e procedurës së prokurimit bashkëngjitur skedulit 4.

b) Të gjitha mallrat dhe shërbimet që do të financohen prej shumës së huasë, do të prokurohen nga vendet e pranueshme, duke siguruar që një pjesë e mallrave dhe shërbimeve mundet që, me miratimin paraprak të Bankës, të prokurohen nga vende të tjera jo më shumë se 21.8% (njëzet e një pikë tetë për qind) të shumës së huasë.

c) Furnizuesit do të jenë nga vende të pranueshme ose persona juridikë të bashkuar dhe të regjistruar, duke siguruar që furnizuesit e pjesës së monedhës së huaj të përshkruar në shtojcën e skedulit 2 do të jenë vendas të Republikës së Koresë ose person juridik, i bashkuar dhe i regjistruar aty.

Seksioni 4.02 Procedura e disbursimit

Huaja do të disbursohet në *won* koreanë nga Banka në përputhje me dispozitat e procedurës së disbursimit bashkëngjitur skedulit 5.

Seksioni 4.03 Pagesat e shërbimit

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës detyrimin e shërbimit në shumën e barabartë me 0.1% (zero pikë një për qind) të shumës së çdo disbursimi në rastin e procedurës me pagesë direkte, dhe/ose të shumës së letrës së angazhimit të procedurës së angazhimit.

b) Një shumë e barabartë për shërbime të tilla do të financohet prej shumës së huasë. Banka do të paguajë shuma të tilla, si pagesa shërbimi në çdo datë të disbursimit dhe/ose të lëshimit të letrës së angazhimit. Disbursime të tilla nga huaja do të përbëjnë disbursim të vlefshëm të huasë sipas Marrëveshjes së huasë.

Neni 5
Marrëveshje të veçanta

Seksioni 5.01 Realizimi i projektit

a) Huamarrësi do ta detyrojë agjencinë e realizimit të projektit për të zbatuar projektin me efiçencë dhe kujdes.

b) Në qoftë se fondet e përdorshme nga shumat e huasë do të jenë të pamjaftueshme për zbatimin e projektit, Huamarrësi do të bëjë menjëherë rregullime për të siguruar fonde të nevojshme, siç mund të kërkohet.

Seksioni 5.02 Raporte dhe informimi

a) Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës ose do ta detyrojë agjencinë e zbatimit të projektit t'i paraqesë Bankës raporte progresive mbi bazë katërmujore në janar, prill, korrik dhe tetor të çdo viti, derisa projekti të plotësohet në formën e tillë siç detajohet në kërkesat e Bankës.

b) Brenda 6 (gjashtë) muajsh pas plotësimit të projektit ose në një datë të mëvonshme që do të bihet dakord midis Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi do t'i japë Bankës një raport në formën dhe detajet siç e kërkon Banka.

c) Deri sa të gjitha detyrimet e Huamarrësit në Marrëveshjen e huasë të jenë kryer plotësisht, Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacione të tjera që Banka mund t'i shohë të arsyeshme t'i kërkojë në lidhje me projektin ose huanë.

Neni 6

Të ndryshme

Seksioni 6.01 Delegimi i autoritetit

a) Huamarrësi këtu emëron agjencinë e realizimit të projektit si agjent të vetin, për qëllimin e saj të marrjes së çdo veprimi apo hyrjes në marrëveshjen e kërkuar apo të lejuar sipas seksionit 4.01 dhe 4.02 dhe 5.02 të Marrëveshjes së huasë.

b) Çdo veprim i marrë ose çdo marrëveshje e hyrë nga agjencia e realizimit të projektit zbatues për autoritetin e dhënë sipas paragrafit (a) të këtij seksioni do të jetë plotësisht i detyrueshëm mbi Huamarrësin dhe do të ketë të njëjtën forcë dhe efekt sikur është marrë nga Huamarrësi.

Seksioni 6.02 Adresat

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 12.05 të termave e përgjithshme dhe kushteve:

Për Bankën
Adresa postale: BANKA EXSPORT-IMPORT E KORESE
16-1, Yoido-dong, Youngdungpo-ku
Seoul, Republika e Koresë
Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm të Departamentit II të EDCF
Telefon No.: 82-2-3779-6581
Fax No.: 82-2-3779-6756

Për Huamarrësin
Adresa postale: MINISTRIA E FINANCAVE
Bulevardi: Dëshmorët e Kombit
Republika e Shqipërisë, Tiranë.
Në vëmendje të: MINISTRIT TË FINANCAVE
Telefon Nr.: 355-4-228405
Fax No.: 355-4-228494

Në dëshmi të kësaj, palët këtu, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre, kanë sjellë këtë Marrëveshje huaje nëpërmjet nënshkrimit me emrat respektivë të datës dhe vitit të shkruar më sipër.

Skeduli 1 - Përshkrimi i projektit

1. Projekti në përgjithësi

a) Objektivat: Projekti synon të kontribojë në mëkëmbjen ekonomike dhe zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë së zonave rurale nga rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit të elektricitetit dhe reduktimin e humbjeve të vazhdueshme të energjisë.

b) Vendndodhja: Zona rurale e jugperendimit të Shqipërisë (Fier, Babicë, Vlorë)

c) Agjencia e realizimit të projektit, KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare)
Adresa postale: Blloku "Vasil Shanto", Republika e Shqipërisë, Tiranë.
Në vëmendje: Drejtori i Planifikim Inxhinieringut, Tel/Fax: 355-4-262 055.

2. Qëllimi i projektit

Projekti është ndarë në shtatë komponentë të mëposhtëm:

a) Linja transmetimi:

(i) Linjë dyfishe transmetimi 220kv midis Fierit dhe Babicës;

(ii) Linja 110 kv ndërmjet Babicës dhe ndërprerje (interseksion);

(iii) Linjë transmetimi 110kv ndërmjet Babicës dhe Vlora 2 dhe;

(iv) Linjë 35kv për lidhjen e nënstacionit të Babicës me 35kv.

b) Nënstacione:

(v) Zgjerim të daljes së linjës së nënstacionit 220/110kv të Fierit;

(vi) Nënstacioni 220/110/35kv i Babicës dhe

(vii) Nënstacioni 110/20kv, Vlora 2

3. Nevojat vjetore të vlerësuara të fondeve (në mijë dollarë)

Viti	Monedha e huaj	Monedha lokale
viti 1	5,850	1,228
viti 2	9,751	2,048
viti 3	3,900	819
Totali	19,501	4,095

Shënim. Të paparashikuarat e skedulit 2 - Caktimi i shumës së huasë nuk është përfshirë.

4. Projekti pritet të përfundojë brenda 34 (tridhjetë e katër) muajsh duke filluar nga data efektive e Marrëveshjes së huasë

Skeduli 2 - Caktimi i shumës së huasë

Caktimi

Tabela e mëposhtme parashtron kategoritë e mallrave, shërbimeve dhe zërave të tjerë që do të financohen prej shumave të huasë dhe përcaktimin e shumave të çdo kategorie të huasë:

(në mijë dollarë amerikane)

Kategori	Shuma e vlerësuar		
	Monedha e huaj	Monedha lokale	Total
A. Punime civile dhe montime	1,015	4,050	4,050
B. Sondazhe dhe inxhinieri	634		1,015
C. Transport lokal dhe sigurimi	16,347	20	654
D. Materiale dhe pajisje	1,480	25	16,372
E. Të ndyshme	974		1,480
F. Të paparashikuara	25	430	1,404
G. Pagesa për shërbime			25
Total	20,475	4,525	25,000

Shënim. Zërat që nuk janë të pranueshme për financim nën kolonën e monedhës lokale janë paraqitur si më poshtë:

(1) Shpenzime të përgjithshme administrative;

(2) Taksa dhe shërbime;

(3) Blerje të tokës dhe prona të tjera reale;

(4) Kompensime;

(5) Zëra të tjera indirekt.

2. Rialokimet

a) Në qoftë se shpenzimet e vlerësuara të zërave të përfshirë në secilën prej kategorive (A)-(E) do të ulen, atëherë shuma e caktuar dhe jo më e nevojshme për të tilla kategori do të rialokohet nga Banka për kategorinë (F).

b) Në qoftë se shpenzimet e vlerësuara të zërave të përfshirë në ndonjë prej kategorive (A)-(E) do të rriten, shuma ekuivalente e këtij porcioni, nëse ka të tilla rritje, do të rialokohet nga Banka me kërkese të Huamarrësit, për kategorinë (A)-(E) nga kategoria (F).

Skeduli 3 - Skeduli i amortizimit

Data Shuma (në koreanë won)

Shënim. Secili këst do të plotësohet kur shuma e huasë të jetë fiksuar në përputhje me seksionin 3.01 të termave dhe kushteve të përgjithshme dhe do të finalizohet pas disbursimit të fundit në përputhje me paragrafin (b) të seksionit 3.02 dhe 7.05 të termave dhe kushteve të përgjithshme.

Skeduli 4 - Procedura e prokurimit

1. Përveç rasteve kur Banka mund të ketë rënë dakord ndryshe, procedurat e referuara në paragrafët e këtij skeduli do të aplikohen për prokurimet e mallrave dhe shërbimeve të financuara sipas shumës së huasë. Termi "Shërbime" në këtë skedul nuk përfshin shërbimet e konsulencës.

2. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve do të bëhet në bazë të rregullave të "Udhëzuesve për prokurimet e kredive të EDCF" të Bankës, datuar në prill 1999 (tani e prapa do të quhen "Udhëzuesit e prokurimit").

3. Huamarrësi do të prokurojë mallra dhe shërbime që do të financohen prej shumës së huasë specifikuar në skedulin 2 përmes tenderit ndërkombëtar të kufizuar midis furnizuesve koreanë.

4. Për kontratat që janë lidhur mbi bazën e tenderit ndërkombëtar të kufizuar, veprimet prokuruese do të jenë subjekt i miratimeve të Bankës në përputhje me procedurat e parashtruara në anekset e udhëzuesve të prokurimit.

Skeduli 5 - Procedura e disbursimeve

1. Procedurat e disbursimit

a) Disbursimet e huasë do të bëhen përmes procedurave angazhuese dhe/ose procedurave me pagesë direkte.

b) "Procedurat e disbursimit nën huatë EDCF" të Bankës datuar në prill 1999 (pas kësaj të quajtur procedurat e disbursimit) do të aplikohen për disbursimin e huasë.

Përcaktimet e bankave

Lidhur me seksionet përkatëse të procedurës së disbursimeve, bankat e përcaktuara janë si më poshtë:

a) Banka paguese referuar seksionit 2.01 do të jetë Banka me zyrën qendrore të regjistruar në 16-1, Yoido-dong, Youngdungpo-gu, Seoul, Republika e Koresë.

b) Banka emetuese referuar në seksionin 2.02 do të jetë Banka e Kursimeve e Shqipërisë, me zyrën qendrore të regjistruar në Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

c) Banka e transfertës referuar në seksionin 3.02, 3.04 dhe 4.04 do të jetë Banka e Këmbimit e Koresë, dega Yoido-Gwangjang në 12, Yoido-dong Youngdungpo-gu, Seoul, Republika e Koresë.

VENDIM
Nr.820, datë 3.12.2004

PËR SHPALLJEN E MUAJIT DHJETOR, "MUAJI I FESTIMEVE TË VITIT TË RI"

Në mbështetje të neneve 95 pika 2 e 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a" të nenit 1 të ligjit nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshillit i Ministrave

VENDOSI:

1. Periudha 1 deri 31 dhjetor, çdo vit, shpallet "Muaji i festimeve të Vitit të Ri".
2. Të gjitha institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, brenda juridiksionit dhe mundësive të tyre financiare, për këtë periudhë, veçmas ose në bashkëpunim, të programojnë, të organizojnë dhe realizojnë infrastrukturën festive dhe veprimtaritë në këtë kuadër.
3. Festimet për vitin 2004 të fillojnë nga data 5 dhjetor.
4. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.828, datë 10.12.2004

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimein publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 6.2/1 të vendimit nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 6.2/2 me këtë përmbajtje:

"6.2/2. Përjashtimisht rregullave të përcaktuara në pikën 6.2 shkollat e larta dhe fakultetet për plotësimin e nevojave të tyre për mallra, shërbime e ndërtime, lejohen që për fondet e tyre buxhetore, të miratuara apo ato të krijuara, t'i kryejnë vetë procedurat e prokurimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.834, datë 10.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

"19. Për punonjësit efektivë, kërkimorë e shkencorë, në institutet kërkimore-shkencore, paga bazë mujore është:

- Drejtues kërkimesh B2;
- Mjeshtër kërkimesh B3;
- Kërkues me gradë shkencore B5.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesë mbi këtë pagë, në përqindje, si më poshtë vijon:

- Drejtor instituti
  Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave 17;
- Zëvendësdrejtor instituti
  Drejtor në qendrën kërkimore-shkencore 13;
- Përgjegjës departamenti 12;
- Përgjegjës qendre kërkimore-shkencore
  Përgjegjës shërbimi
  Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave 10;
- Përgjegjës seksioni
  Përgjegjës klinike
  Përgjegjës sektori 8.

Punonjësve, që nuk janë efektivë të shkollave të larta ose të instituteve kërkimore-shkencore, por janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e këtyre shkollave ose instituteve, si dhe punonjësve efektivë të shkollave të larta, që nuk janë punonjës pedagogjikë (janë nëpunës) u jepet shpërblim mujor, si më poshtë vijon:

- Profesor, drejtues kërkimesh 5600 lekë;
- Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh 4900 lekë;
- Për gradën shkencore "doktor i shkencave" 4200 lekë.".

2. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

"19/1. Për punonjësit efektivë, pedagogjikë-shkencorë e kërkimorë në shkollat e larta, me kohë të plotë, paga bazë mujore është:

- Profesor A 8;
- Profesor i asociuar A 11;
- Pedagog me gradë shkencore B 2.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesë mbi këtë pagë, në përqindje, si më poshtë vijon:

- Rektor i universitetit të kategorisë I 25;
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë I
  Rektor i universitetit të kategorisë II 20;

- Zëvendësrektori i universitetit të kategorisë II 17;
- Dekan, kancelar i universitetit të kategorisë I 15;
- Zëvendësdekan,
  Kancelar në universitetin e kategorisë II 13;
- Përgjegjës departamenti 12;
- Kancelar në fakultet 10;
- Përgjegjës seksioni, përgjegjës sektori 8.".

3. Në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", të bëhen këto ndryshime:

a) Në klasifikimin "A2" shtohet emërtesa "Kryetar i Akademisë së Shkencave".

b) Paga për këtë klasifikim bëhet "150 000 lekë".

c) Në klasifikimin "A3" shtohen emërtesat "Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave" dhe "Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave";

ç) Paga për këtë klasifikim bëhet "117 000 lekë";

d) Në klasifikimin "A6" shtohet emërtesa "Akademik";

dh) Në klasifikimin "B3" shtohet emërtesa "Pedagog";

e) Në klasifikimin "B4" shtohet emërtesa "Asistent në shkollat e larta";

ë) Në klasifikimin "A4" emërtesa "Kryetar i Akademisë së Shkencave", shfuqizohet;

f) Në klasifikimin "A8" emërtesat "Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave" dhe "Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave" shfuqizohen;

g) Në klasifikimin "B1" emërtesa "Akademik", shfuqizohet;

gj) Në klasifikimin "C2" emërtesa "Pedagog", shfuqizohet.

4. Lidhja II-8 "Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Mbi pagat e caktuara sipas këtij vendimi zbatohet indeksimi i përcaktuar në vendimin nr.184, datë 10.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për masën e indeksimit të pagave për vitin 2004".

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja II-8

Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave
I.

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi/paga
1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	A2
2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	A3
3	Akademik	A6
4	Drejtues kërkimesh	B2
5	Mjeshtër kërkimesh	B3
6	Kërkues me gradë shkencore	B5
7	Kërkues	C2

II.

Nr.	Emërtimi	Klasa	Shtesë për funksion
8	Sekretar shkencor seksioni,përgjegjës sektori	X	6
9	Kryetar dege	IX	5
10	Specialist	VII-VIII	
11	Përgjegjës administrate	VI	1
12	Arkivist	VII	
13	Redaktor, përkthyes, sekretar i kryetarit	VI	
14	Përgjegjës ofiçine	V	1
15	Llogaritar i parë, ekonomist	V	
16	Shofer	II-III	
17	Arkëtar, daktilografist	III	
18	Portier, pastrues, korier	I	

UDHËZIM
Nr.7, datë 16.12.2004

MBI PËRCAKTIMIN E NORMAVE TEKNIKE PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9220, datë 15.4 2004 "Për shërbimin publik të varrimit ", Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit

UDHËZON:

1. Në planet rregulluese të qendrave të banuara të përfshihet edhe projekti për ndërtimin e varrezave, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e urbanistikës të miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së urbanistikës".

2. Vendi i ndërtimit të varrezave duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë jashtë territorit të banimit dhe i ndarë nga ajo nëpërmjet zonës së rezervuar, sikurse kërkohet nga ligji;

b) Toka të mos mbajë ujë dhe të mos jetë mbi qendrën e banuar;

c) Të mos jetë në afërsi të burimeve të ujit të pijshëm, ujit industrial ose lumenjve, në raste të tilla të merret mendimi me shkrim edhe i specialistëve të hidrogjeologjisë për formacionet karstike;

d) Tubacionet e rrjetit të jashtëm të ujësjellësit duhet të vendosen jo më pak se 30 m, larg nga muri rrethues i territorit të varrezave.

3. Vendi ku do të ndërtohen varrezat duhet të ketë parasysh kushtet higjienike dhe ambientale të mëposhtme:

a) të ketë lidhje me komunikacionin dhe rrjetin urban rrugor, por të mos jetë afër me rrugët kryesore që kanë trafik të madh rrugor;

b) të bëhet studimi për përbërjen granulometrike të shtresës së tokës për të përcaktuar aftësinë e mineralizimit të kufomave dhe evitimin e ndotjes të ujërave nëntokësore;

c) të jetë e mundur lidhja me rrjetin urban të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe me drenazhimet për kullimin e ujërave, me kosto sa më të ulët;

d) të studiohen kanalizimet e ujërave të shiut, në mënyrë që rrjedhja e tyre të jetë në drejtim të kundërt të qendrave të banimit.

4. Në zonën e varrezave terreni duhet të jetë i shkrifët në thellësinë 2 deri 2,5 m në mënyrë që të mos jetë e vështirë hapja e varrit. Toka të jetë relativisht e thatë dhe me një porozitet të pranueshëm që të mbajë sasinë e ujit të nevojshëm për të realizuar procesin e mineralizimit të kufomës. Për këtë duhet që paraprakisht të bëhen provat për të përcaktuar përbërësit kimiko-fizikë dhe porozitetin e tokës.

5. Mbas provave të mësipërme, në mënyrë skematike mund të kemi:

- Terrene të përshtatshme ato që përmbajnë zhavorishte, ranore, pocolanike me një sipërfaqe mesatarisht kompakte dhe të përshkueshme.

- Terrene të papërshtatshme ato që përmbajnë shkëmborë kompakt ose mesatarisht kompakt, argjilo-ranorë ose materiale të shkrifëta shumë të ngjeshura e të papërshkueshme.

Kur në një qendër banimi nuk gjendet një terren i përshtatshëm, mund të përshtatet, duke realizuar hapjen e varreve si më poshtë:

- Hapet gropa e varrit deri në thellësinë 2 metra;

- Në fund të gropës, në funksion të drenazhimit, sistemohet një shtresë zhavorri me trashësi 0.3 metra, mbi të cilën vihet arkivoli;

- Mbulimi i gropës së varrit bëhet me tokë të përzier me 50 % rërë. Për raste të tilla duhet që në zonën e varrezave të jetë e depozituar një sasi e konsiderueshme zhavori dhe rëre për ta përzier.

6. Sipërfaqja e pjesës së tokës të destinuar si fushë varrimi duhet parashikuar dhe llogaritur mbi bazën e numrit të banorëve të bashkisë apo komunës përkatëse dhe rritjes së popullsisë së tyre në 10 vitet e fundit, si dhe të dhënave statistikore të varrimeve të kryera në dhjetëvjeçarin e fundit, me destinacion për të varrosur kufomat për një periudhë normale jo më pak se prej 10 vjetësh. Kur kjo periudhë fiksohet për një periudhë të ndryshme nga 10 vjet, sipërfaqja e varrezave llogaritet në mënyrë proporcionale.

7. Në përcaktimin e sipërfaqes së tokës të destinuar për fushë varrimi, duhet të merren parasysh edhe varrimet që do të kryhen si pasojë e zhvarrimeve, si dhe mundësia e ngjarjeve të jashtëzakonshme, të cilat mund të kërkojnë një numër të madh varrimesh.

8. Në sipërfaqen e projektuar për ndërtimin ose zgjerimin e varrezave duhet të llogariten edhe hapësirat eventuale të rezervuara:

a) për ndërtimin e të gjitha godinave të destinuara për shërbimet e varrimit ose në dispozicion të publikut apo punonjësve të varrezave;

b) për rrugët, rrugicat, sheshet dhe zonat e parkimit;

c) për çdo qëllim tjetër të nevojshëm, përveç atij të varrimit.

9. Ndërtimi i zyrave administrative apo objekteve higjieno-sanitare, parashikohet në pozicionet e hyrjes kryesore të varrezave, madhësia e të cilave varet nga numri i punonjësve dhe dimensionet e varrezave. Pranë çdo varreze të ndërtohen objekte higjienike për publikun, të ndara sipas seksit, në një pozicion të përshtatshëm të varrezave.

10. Në projektin e territorit të varrezave, sipërfaqja e brendshme duhet të ketë formë të rregullt, të jetë e ndarë në parcela të sistemuara e të gjelbëruara, me rrugë të brendshme dhe me rrugë kryesore që lidhet me qendrën e banimit, gjerësia e të cilave lejon një qarkullim të lehtë të makinave funerale dhe të vizitorëve. Gjatë gjithë këtyre rrugëve, duhet të ketë gjelbërim, lule dhe pemë dekorative.

11. Toka e varrezave duhet të jetë e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me kanale sipërfaqësore për heqjen e shpejtë të ujërave të shiut dhe aty ku është e nevojshme me drenazhim, mjaft që ky drenazhim të mos sjellë një tharje të tepërt të tokës.

12. Kur afër varrezave duhet të kalojë patjetër kanali vaditës veprohet në këtë mënyrë:

a) Kur kanali kalon në anën e sipërme të varrezave, të bëhet hidroizolimi i tij.

b) Kur kanali kalon në anën e poshtme të varrezave, të gjitha ujërat atmosferike që mblidhen nga sipërfaqja e tokës, grumbullohen në një kanal dhe kalojnë nën kanalin vaditës.

13. Varrezat publike duhet të rrethohen gjatë gjithë perimetrit nga një mur rrethues ose nga një rrethim tjetër i përshtatshëm, që duhet të ketë një lartësi jo më të vogël se 2.5 deri 4 m nga sipërfaqja e tokës jashtë rrethimit. Kur terreni është i thyer të ndërtohen mure mbajtës dhe pritës.

14. Sipas madhësisë së territorit të varrezave, përcaktohet edhe numri i hyrjeve për në të. Hyrjet e automjeteve funerale mund të jenë të njëjta me ato të këmbësorëve ose të ndara.

15. Vendqendrimi i rojave ndërtohet në një pozicion të përshtatshëm vrojtimi për të kontrolluar hyrjet në varreza, objektet funksionale të ndërtuara në të dhe të gjithë territorin e varrezave.

Në territorin e varrezave nuk lejohet të bëhen ndërtime të llojeve të ndryshme, me përjashtim të atyre që janë në shërbim të varrezave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE I TURIZMIT
Bashkim Fino

UDHËZIM
Nr.8, datë 17.12.2004

MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË PËRDORIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE, MËNYRËS SË HAPJES SË VARREVE DHE TË DHËNAT TEKNIKE TË ARKIVOLEVE QË PËRDOREN

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 15 pika 3 të ligjit nr.9220, datë 15.4 2004 "Për shërbimin publik të varrimit ", Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

I. Bashkitë ose komunat gjatë administrimit të varrezave publike, duhet të kenë parasysh kushtet e përdorimit të tyre:

1. Çdo bashki ose komunë që ka të paktën një varrezë publike, duhet të ketë vetëm një ndërmarrje, sektor, njësi etj. për administrimin e varrezave publike.

2. Gjatë përdorimit të varrezave të respektohet me rreptësi, sipas ligjit, "zona e rezervuar", e cila është një sipërfaqe e mbjellë me pemë dhe gjelbërime.

3. Në "zonën e rezervuar" mund të lejohet parkimi i makinave, vende për shitjen e luleve dhe kabina për ndriçim, ujësjellës e kanalizim, për të mos i lejuar këto brenda territorit të varrezave.

4. Ndalohet kullotja e bagëtive dhe lëvizja e mjeteve dhe këmbësorëve në territorin e varrezave publike.

5. Ndalohet kryerja e punimeve në varreza publike nga subjekte të tjera, përveç atij të saktësuar si administrues i territorit të varrezave publike. Në rast shkeljeje merren masa deri në denoncim penal.

6. Territori i varrezave publike është pronë publike e paluajtshme e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, prandaj nuk lejohet shitja ose kontraktimi me pagesë i vendeve të varrimit. Në raste shkeljeje bëhet denoncim pranë organeve kompetente.

7. Rregullin dhe disiplinën për hapje-mbyllje varri, veshje me pllaka të brendshme betoni, ndërtimin e bordurave mbitokësore, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varrezave e kryen ndërmarrja publike vendore ose një firmë private e licencuar.

8. Varrimi i kufomave bëhet 24 orë nga momenti i vdekjes, me lejen e varrimit të organeve të bashkisë ose komunës. Leja e varrimit jepet pasi të dorëzohet në gjendjen civile skeda e vdekjes, e cila jepet nga mjeku i familjes.

Kur kufoma ka vdekur nga një sëmundje infektive, sipas skedës së vdekjes, kjo shkruhet edhe në lejen e varrimit në mënyrë që të kryhet një varrim i veçantë dhe rigoroz sipas të gjitha rregullave të këtij ligji.

9. Drejtuesi i sektorit me marrjen në dorëzim të lejes së varrimit, përcakton parcelën, rrjeshtin dhe numrin e varrit, si dhe orarin kur do të kryhet varrimi i kufomës. Gjithashtu regjistron në regjistrin e shërbimit të varrimit të gjitha të dhënat e nevojshme që kërkohen.

10. Çdo varr dallohet nga një pllakë e përbërë prej materiali rezistent ndaj veprimit shkatërrues të agjentëve atmosferikë dhe që ka një numër progresiv. Mbi pllakën e varrit vendoset një target prej materiali të paprishëm që përmban: emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes e të vdekjes së të ndjerit.

11. Brenda një afati prej 2 muaj mbas mbulimit të kufomës të përfundojë nivelimi i terrenit rreth varrit dhe vendosja e bordurave kufizuese betonarmeje. Një vit mbas varrosjes, familjarët e të ndjerit mund të bëjnë rregullimin dhe zbukurimin përfundimtar të varrit.

12. Të mos lejohet rrethimi i varrit me mjete dekorative ose kangjella në mënyrë të tepruar, duke mos respektuar dimensionet e varreve dhe të rrugicave ndërmjet tyre. Zbukurimi i varrit bëhet vetëm brenda bordurave kufizuese të tij.

13. Bashkitë dhe komunat mund të përcaktojnë edhe kritere të tjera për kushtet e përdorimit të varrezave publike, në përputhje me ligjin nr.9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".

II. Subjekti që administron varrezat duhet të ndjekë këto mënyra për hapjen e varreve:

1. Fusha e varrezave ndahet në kuadrate dhe hapja e gropave të varrit fillon nga njëri ekstrem i secilit kuadrat dhe vazhdon rrjesht pas rrjeshti pa e ndërprerë vijueshmërinë e gropave. Kjo përcaktohet që në fillim të shfrytëzimit të një kuadrati, duke bërë një piketim paraprak të fushës.

2. Secili kuadrat ndahet nga tjetri nëpërmjet rrugëve të brendshme, të cilat bashkohen me rrugën kryesore të varrezave. Këto rrugë të jenë të gjelbëruara dhe të pajisura me kosha për hedhjen e mbeturinave.

3. Për një përdorim sa më të mirë, kuadratet e varrezave të shfrytëzohen sipas mënyrave të mëposhtme:

a) me dy rrjeshta varresh (binare) të kufizuara nga rrugicat që kalojnë ndërmjet tyre;

b) me tre rrjeshta varresh (ternare) të kufizuara nga rrugicat që kalojnë ndërmjet tyre;

c) me katër rrjeshta varresh (kuaternare) të kufizuara nga rrugicat që kalojnë ndërmjet tyre.

4. Sipas dimensioneve të territorit të varrezave dhe karakteristikave ambientale të saj, duhet të përdorim njërën nga mënyrat e mësipërme. Përdorimi i kuadrateve me dy rrjeshta varresh është ai që paraqet një pamje më të gjelbëruar dhe më të qartë.

5. Çdo gropë varri gërmohet në thellësinë 1.3 deri 2 m. nga sipërfaqja e tokës dhe pasi të jetë vendosur arkivoli, mbulohet në mënyrë të tillë që dheu i marrë nga sipërfaqja të vendoset rreth arkivolit, ndërsa dheu i marrë nga thellësia të vendoset në sipërfaqe.

Kur tek varri përdoren pllaka parafabrikate, shtresa që mbulon vendoset në thellësinë më të madhe se 50 cm nga sipërfaqja e tokës dhe pastaj mbulohet me dhe.

6. Kufomat e personave me moshë më të madhe se 10 vjeç, varrosen në gropa me thellësi jo më të vogël se 1.3 m; me gjatësi 2 m dhe gjerësi 0.9 m, si dhe të jenë larg njëra-tjetrës të paktën 0.5 m për çdo anë.

7. Kufomat e personave me moshë më të vogël se 10 vjeç, varrosen në gropa me thellësi jo më të vogël se 1.3 m, me gjatësi 1.5 m dhe gjerësi 0.5 m, si dhe të jenë larg njëra-tjetrës të paktën 0.5 m për çdo anë.

8. Kufomat e personave që kanë vdekur nga sëmundje infektive, varrosen në gropa me thellësi jo më të vogël se 2 m , me gjatësi 2 m dhe gjerësi 0.9 m.

9. Rrugicat ndërmjet varreve, që shtrihen për gjatë gjerësisë prej 0.5 m që ndan varrin nga varri, të jenë të pajisura me sisteme kullimi për mbledhjen dhe largimin e ujërave të rreshjeve larg varreve.

10. Nxjerrja dhe shpërngulja e eshtrave nga një vend te tjetri nuk bëhet pa kaluar minimumi 5 vjet nga data e varrimit të kufomës. Në këtë rast transportimi i eshtrave bëhet me kutia llamarin, ose ambalazhohen në dy thasë ku i brendshmi patjetër të jetë plastik dhe i dezinfektuar.

Para mbulimit të varrit të hapur nga zhvarrimi, aty hidhen lëndë dezinfektuese. Gjithashtu lëndë dezinfektuese hidhet edhe mbas mbulimit të varrit në territorin ku u përhap dheu i nxjerrë nga varri.

III. Të dhënat teknike të arkivoleve do të jenë:

1. Çdo kufomë e destinuar për t'u varrosur nën tokë, të jetë e mbyllur në një arkivol prej druri dhe të varroset në varr të veçantë nga të tjerët.

Vetëm nëna dhe i porsalinduri, të vdekur gjatë lindjes, mund të mbyllen në të njëjtin arkivol dhe të varrosen në të njëjtin varr.

2. Për varrimin nëntokësor nuk lejohen arkivole prej metali apo materiali tjetër që nuk degradohet biologjikisht. Gjithashtu nuk lejohet përdorimi i materialeve që nuk degradohen biologjikisht edhe në pjesët dekorative të arkivolit.

3. Kur bëhet fjalë për kufoma që vijnë nga jashtë shtetit ose bashki apo komuna të largta, për të cilat është i detyrueshëm përdorimi i arkivolit me mure të dyfishta, druri dhe metalike, varrosja kryhet vetëm pas bërjes së disa çarjeve me dimensione të përshtatshme arkivolit metalik.

4. Përdorimi për arkivol i materialeve biologjikisht të padegradueshme, jo prej druri, bëhet i autorizuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror. Kufomat e atyre që kanë vdekur nga sëmundje ngjitëse infektive vendosen në arkivole me mure të dyfishtë, druri dhe metalik, dhe që nga momenti i mbylljes është e ndaluar hapja e tij, në fund të arkivolit hidhet lëndë dezinfektuese.

5. Çdo arkivol të përmbajë vulën me djegie të firmës prodhuese, si dhe të firmës furnizuese.

6. Trashësia e dërrasave të arkivolit duhet të jenë jo më pak se 0.8-2 cm. Dërrasat e fundit të arkivolit, një copëshe në gjatësi, bashkohen për të formuar gjerësinë e duhur dhe të jenë të puthitura dhe të ngjitura fort midis tyre me ngjitës të sigurt dhe që mbajnë gjatë.

7. Fundi i arkivolit bashkohet me dërrasat anësore me gozhda çdo 20 cm, si dhe të sigurohet me ngjitës të posaçëm. Dërrasat anësore të jenë të ngjitura fort me ngjitës të sigurt dhe që mbajnë gjatë. Kapaku i arkivolit mbërthehet me dërrasat e tjera me vida çdo 40 cm.

8. Arkivolet ndërtohen edhe me pllaka fibre të tipit entjef (M.D.F.) trashësia e të cilave të jetë jo më e vogël se 0.8-2 cm. Fundi i arkivolit bashkohet me faqet anësore me ngjitje speciale dhe në çdo 30 cm nga brenda saj shtrëngohen me disa kapëse speciale (grapeta). Me kapëse speciale dhe me ngjitje shtrëngohet edhe kapaku i arkivolit. Këto arkivole vishen nga brenda dhe nga jashtë me materiale dekorative.

9. Arkivolet ndërtohen edhe me pllaka zdrukthi të melaminuara, me trashësi jo më të vogël se 0.8-2 cm. Edhe në këtë rast ngjitja e materialit duhet të bëhet me ngjitje speciale dhe në çdo 30 cm të shtrëngohet me kapëse (grapeta).

10. Firmat prodhuese dhe ato tregëtuese të arkivoleve duhet të zbatojnë kushtet e mësipërme. Respektimi i tyre do të kontrollohet herë pas here nga njësitë e pushtetit vendor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE I TURIZMIT
Bashkim Fino

URDHËR
Nr.532, datë 6.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E MINISTRIT NR.98, DATË 26.2.2004 "MBI TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE, TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET VARTËSE TË SISTEMIT TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.07.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve,

URDHËROJ:

Në urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit nr.98, datë 26.2.2004 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1/IV. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve bëhet si vijon:

IV. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve, në mbështetje të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", tarifat e shërbimeve që do të kryhen nga inspektorët e mbrojtjes së bimëve të DRBU–së, të jenë:

PËR MBROJTJEN E BIMËVE

A. Inspektim fitosanitar i bimëve dhe produkteve bimore:

Inspektim fitosanitar dhe/ose pajisje me certifikatë fitosanitare për bimët e produktet bimore që importohen, eksportohen, rieksportohen ose lëvizin brenda vendit.

1. Material mbjellës

1.1 Fidanë të drufrutorëve, hardhive, ullinjve, bimëve dekorative dhe lule në vazo

deri 1000 copë	500 lekë
mbi 1000, për çdo 100 copë shtesë	50 lekë
mbi 5000 copë	3000 lekë

1.2 Fidanë të perimeve e luleve , lule të prera për buqeta dhe pjesë vegjetative për prodhim fidanësh drufrutorë, vreshti etj.

deri 10 000 copë	500 lekë
mbi 10 000, për çdo 1000 copë shtesë	50 lekë
mbi 50 000 copë	3000 lekë

1.3 Fara të imta të luleve e perimeve (domate e solanace të tjera, lakër e kryqore të tjera, karrotë, erëza të ndryshme, trangull dhe kukurbitace të tjera etj.)

deri 10 kg	1000 lekë
mbi 10 kg, për çdo 10 kg shtesë	100 lekë
mbi 100 kg	3000 lekë

1.4 Farëra të mëdha si tuberë, bulba, drithëra, bishtajore, spinaq, bamje, foragjere dhe të tjera të ndryshme nga farërat e përmendura në pikën 1.3

deri në 10 ton	1000 lekë
mbi 10 ton, për çdo 1 ton shtesë	100 lekë
mbi 30 ton	5000 lekë

2. Lëndë druri

deri në 10 ton ose m^3	500 lekë
mbi 10 ton, për çdo 1 ton ose m^3 shtesë	100 lekë
mbi 30 ton ose m^3	3000 lekë

3. Tokë, komposto dhe mjedise të tjera organike dhe inorganike për kultivimin e bimëve

deri në 10 ton	500 lekë
mbi 10 ton, për çdo 1 ton shtesë	100 lekë
mbi 30 ton	3000 lekë

4. Bimë e produkte bimore për konsum

deri 10 ton	500 lekë
mbi 10 ton, për çdo1 ton shtesë	50 lekë
mbi 30 ton	2000 lekë

B. Inspektime fitosanitare fushore për një cikël bimor

1. Inspektim fushor për material mbjellës e shumëzues

Parcela deri në 1 ha	1000 lekë
mbi 1 ha, për cdo 1 ha shtesë	100 lekë
mbi 40 ha	5000 lekë

2. Inspektim fushor për bimë e produkte bimore për konsum

Parcela deri në 10 ha	500 lekë
mbi 10 ha, për çdo 1 ha shtesë	50 lekë
mbi 20 ha	2000 lekë

C. Shërbime të tjera:

1. Leje për importimin dhe tregtimin e PMB 5000 lekë
2. Inspektimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në pikat kufitare të hyrjes 1000 lekë për çdo produkt

D. Diagnostikim në laborator:

1.Diagnostikim sëmundjesh dhe dëmtuesish me metoda mikroskopike 1000 lekë për çdo diagnostikim

2. Diagnostikim sëmundjesh e dëmtuesish me metoda laboratorike (mbjellje, kultivim artificial etj.) 2000 lekë për çdo diagnostikim

Shënim. Vlera e tarifës i përgjigjet mallit të një partie, që do të thotë kg, ton, m^2 apo copë, bimë e produkte bimore që :

- i përkasin të njëjtit lloj/kultivar;
- kanë të njëjtën origjinë;
- gjendja fitosanitare e tyre deklarohet në një certifikatë fitosanitare.

2. Kreu IV i urdhrit të Ministrit nr.98, datë 26.2.2004 ”Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit” që ka të bëjë me tarifat e aplikueshme nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimeve, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe të Ushqimit

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
Agron Duka

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kthesa e Shëngjinit-Ura e Re Lezhë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU LEZHE

Lista e pronareve qe preken nga ndertimi i segmentit rrugor " Kthesa e Shengjinit - Ura e re Lezhe "

Lloji i pasurise se paluajtshme: Truall dhe Objekte

Nr	Emer	Atesia	Mbiemri	Nr. pas.	Truall			Objekte			Vlera	
					Sip. m2	Cmimi l/m2	Vlera leke	Sip. m2	Cmimi l/m2	Vlera leke	Totale leke	Shenime
	Prek	Nikoll	Ivanaj									
	Fize	Nikoll	Ivanaj									
1	Mark	Nikoll	Ivanaj	1/10,	592	1583	937136				937136	
	Ndue	Nikoll	Ivanaj									
	Luigj	Nikoll	Ivanaj									
	Mara	Nikoll	Ivanaj									
	Prenda	Nikoll	Ivanaj									
	Prek	Nikoll	Ivanaj									
	File	Nikoll	Ivanaj									
	Mark	Nikoll	Ivanaj									
2	Ndue	Nikoll	Ivanaj	1/24,	131	1583	207373				207373	
	Luigj	Nikoll	Ivanaj									
	Mara	Nikoll	Ivanaj									
	Prenda	Nikoll	Ivanaj									
3	Pashk	Ndoc	Matia	8/102				80	amort.6%	3869124	3869124	
4	Lumturije		Pjedrushi	8/132				74	amort.8%	3509503	3509503	
5	Shefqet		Nika	13/63,				32		130000	130000	
6	Gjergj	Mark	Prenga	10/56,				20		160000	160000	
7	Gjon	Nikoll	Gjoka	10/56,				41.8		2000000	2000000	
8	Marselin	Hil	Ndreca	13/84,				181.5	amort.3%	14257001	14257001	
9	Gjok	Gjon	Ndoka	9/39,	137	1583	216871	63		3000000	3216871	
	Lace		Salihi									
10	Lumnije	Vehbi	Salihi	8/100,				60		3000000	3000000	
	Izet	Vehbi	Salihi									

	Adelina	Vehbi	Salihi									
11	Luigj	Kol	Gjoka	8/133,	160	1583	253280				253280	
12	Luigj	Kol	Gjoka	8/134,	94	1583	148802				148802	
13	Gjergj	Kol	Gjoka	8/131,	35	1583	55405				55405	
		Totali			**1149**	**1583**	**1818867**	**552.3**		**29925628**	**31744495**	

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën "Për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve përfshihen në projektin e ristrukturimit të Aeroportit të Rinasit".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është "ShA Albatransport".

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE TË PASHPRONËSUAR TË FAMILJES "LILA" QË NDODHET BRENDA PROJEKTIT TË RISTRUKTURIMIT TË AEROPORTIT TË RINASIT

Lloji i pasurisë së paluajtshme e tokës arë (trajtuar si truall)

Nr	Emër	Atësia	Mbiemri	Nr.pas.	Tokë are (trajtuar si truall)		
					Sip/m^2	Çmimi l/m2	Vlera lekë
1	Liman	Ramazan	Lila	11/16,	3861	6000	23166000
2	Sabri	Xhemal	Lila	11/17,	2925	6000	17550000
3	Shaban	Xhemal	Lila	11/19,	2691	6000	16146000
4	Islam	Tug	Lila	11/21,	6786	6000	40716000
5	Sabri	Xhemal	Lila	12/19,	8680	6000	52080000
6	Shaban	Xhemal	Lila	12/20	4800	6000	28800000
7	Liman	Ramazan	Lila	12/18,	3600	6000	21600000
			Shuma		**33343**		**200058000**

KËRKESË

Shtetësja Eftimia Trifoni, e datëlindjes 5.3.1936, lindur në Çatis Gjirokastër dhe banuese në Vlorë, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj Piro Trifoni.

KËRKUESE
Eftimia Trifoni

Fletorja Zyrtare gjendet:
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	**1500**
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	**2000**

Doli nga shtypi më 20.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë